



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 103, Datë 30.04.2018

MBI

MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PAJTUESHMËRISË SË OST SH.A.

Në mbështetje të neneve 16 dhe 54, pika 6 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC; nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016 si dhe vendimit të bordit të ERE nr. 43, datë 15.03.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të Certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.04.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi miratimin e Programit të Pajtueshmërisë së OST sh.a,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE me vendimin nr. 43, datë 15.03.2017, ka miratuar Certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a.
- Në vendimin nr. 43, datë 15.03.2017 të Bordit të ERE, është parashikuar që, Programi i Pajtueshmërisë duhet t’i dorëzohet autoritetit rregullator ERE, jo më vonë se 6 muaj pas caktimit të Zyrtarit të Pajtueshmërisë. Ndërkohë që Zyrtari i Pajtueshmërisë duhet të caktohet jo më vonë se 3 muaj pas miratimit të Vendimit final të Certifikimi.
- Me vendimin nr. 147, datë 28.09.2017, bordi i ERE ka vendosur për miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë dhe miratimin e emërimit të zyrtarit të pajtueshmërisë të propozuar nga OST sh.a.
- Këshilli Mbikqyrës i shoqërisë OST sh.a. me vendimin nr. 2, datë 21.01.2018 ka miratuar Programin e Pajtueshmërisë së OST sh.a.
- Shoqëria OST sh.a. me shkresën nr. 962 Prot., datë 31.01.2018 i është drejtuar ERE me kërkesën për miratimin e Programit të Pajtueshmërisë së OST sh.a.
- Bordi i ERE me vendimin nr.46, datë 07.03.2018, filloi procedurën për miratimin e programit të pajtueshmërisë së OST sh.a.
- Ky vendim u publikua në shtypin e shkruar me qëllim marrjen e komenteve dhe opinionit të palëve të interesit mbi këtë vendimmarrje.

- Ky vendim i ERE për fillimin e procedurës së miratimit të Programit të pajtueshmërisë së OST sh.a. i'u dërgua për mendim Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autortetit të Konkurrencës dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë.
- Në përfundim të afateve parashikuara rezulton se nuk ka ardhur asnjë koment apo sugjerim mbi këtë program dhe vendimmarrjen e ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të miratojë Programin e Pajtueshmërisë së OST sh.a. (Bashkëlidhur)
2. Drejtorja e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë OST sh.a, Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI